

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN OTLLAK (NJËSI ADMINISTRATIVE E BASHKISË BERAT)

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën e Otlaku, njësi administrative e bashkisë Berat**, me objekt: “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.05.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 128, datë 24.09.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 619/8, datë 24.09.2015, i ka rekomanduar z. Përparim Sinaj, Kryetar i bashkisë Berat, ku përfshihet njësi administrative Otlak, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nuk janë programuar për tu paguar detyrimet kreditore të pa likuiduara në vitet paraardhës për vlerën **11,464,856 lekë**, në kundërshtim me kërkesat UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” (Trajtuar në pikën 3 të programit të auditimit, faqet 22-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Bashkia Berat (në të cilën përfshihet si njësi administrative ish Komuna Otlak) të marrë masa dhe të implementojë të dhënat e bilancit financiar të ish Komunës Otlak në bilancin e vet financiar dhe të ndjekë të gjitha detyrimet kreditore të ish Komunës Otlak, të cilat sipas bilancit financiar për vitin 2014, janë në shumën **11,464,856 lekë**.

Të procedojë sipas kërkesave ligjore për pagesat e detyrimeve mbi kreditorët e ish Komunës Otlak.

Brenda muajit Mars 2016

2.Gjetje nga auditimi: Komuna Otlak ka nxjerrë pasqyrat financiare për aktivitetin e vitit 213, 2014 dhe për 6 mujorin e vitit 2015.

Mbajtja e kontabilitetit si dhe pasqyrat financiare, nuk japin të dhëna mbi aktivitetin e komunës për furnizimin me ujë të pijshëm të familjarëve. Për rrjedhojë, nuk ka të dhëna kontabël nëse ky aktivitet ka qenë rentabile, ose jo dhe deri në çfarë mase është financuar nga të ardhurat lokale, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar neni 7, 8, 14.

-Llogari 202 “Shpenzime për studime ose kërkime”, për vlerën e debisë 3,141,000 lekë, përfaqëson studime, për të cilat nuk janë hapur kartela inventariale dhe për rrjedhojë nuk dihet nëse janë efektive.

Mungesa e kartelave inventariale, për sa janë regjistruar në debi të kësaj llogarie studime dhe projekte, është praktikë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73.

2.1.Rekomandimi: Bashkia Berat (në të cilën përfshihet si njësi administrative ish Komuna Otlak) të marrë masat dhe të:

-Të programojë shpenzimet dhe të ardhurat për administrimin e ujësjellësit të ish Komunës Otlak.

-Të inventarizojë gjithë dokumentacioni teknik si projekte, preventiva dhe studime të kryera në vite në ish Komunën Otlak, të cilat sipas të dhënave të pasqyrave financiare, janë vlerësuar në vlerën kontabël **3,141,000 lekë**.

Brenda muajit Dhjetor 2015

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua gjendja e debitorëve për detyrimet tatimore, taksat dhe tarifave vendore për 132 subjekte të biznesit të vogël, 34 subjekte të biznesit të madh dhe popullatës për taksën e tokës, të ndërtesës dhe tarifën e pastrimit, **është 19,420,000 lekë**.

Nga zyra e tatim taksave, nuk janë llogaritur masa e gjobës, për mos pagimin e detyrimeve në afat në shumën 74,632 lekë ndaj 132 subjekteve të biznesit të vogël, në kundërshtim me kërkesat

e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 114.

3.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Berat, të merren masat e nevojshme për vjeljen e detyrimeve tatimore, taksat dhe tarifat vendore për 132 subjekte të biznesit të vogël, 34 subjekte të biznesit të madh dhe popullatës për taksën e tokës, të ndërtesës dhe tarifën e pastrimit, **është 19,420, 000 lekë** përfshi edhe penalitetin e llogaritur për mospagimin në afat të detyrimeve tatimore.

Brenda muajit Mars 2016

4. Gjetje nga auditimi: Nuk janë kryer të gjithë hapat e nevojshme ligjore, të përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, për regjistrimin e pronave në pronësi të ish Komunës Otlak (Njësia Administrative Otlak) në ZVRPP Berat.

4.1.Rekomandimi: Bashkia Berat (në të cilën përfshihet si njësi administrative ish Komuna Otlak), të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e pronave dhe për krijimin e regjistrit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Komunës Otlak (Njësia Administrative Otlak), në zbatim të akteve nënligjore dhe të vërë në efikasitet ato, nëpërmjet dhënies me qera në zbatim të kërkesave ligjore.

Brenda muajit Dhjetor 2015

6. Gjetje nga auditimi: Nga struktura e IMKT-së të, janë marrë 19 vendime pezullimi për raste të konstatuara ndërtime në papajtueshmëri me legjislacionin në fuqi për të cilat nuk është marrë asnjë masë dënimi me gjobë, duke krijuar të ardhura të munguara në shumën **5,700,000 lekë**, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 për “Planifikimin e Territorit” ku në germën “a”, nuk është marrë asnjë vendim për prishje ose kallëzime penale, ndaj subjekteve që kanë kryer ndërtime pa leje, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV”.

6.1.Rekomandimi: Bashkia Berat (në të cilën përfshihet si njësi administrative ish Komuna Otlak) të vlerësojë gjendjen e territorit të ish Komunës Otlak dhe për rastet e ndërtimeve pa leje, të procedojë sipas kërkesave ligjore, si dhe të marrë masa për arkëtimin e shumës **5,700,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore.

Brenda muajit Dhjetor 2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Bashkia Berat (në të cilën përfshihet si njësi administrative ish Komuna Otlak), të kryej kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera, në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me **vlerën 4,161,721 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

Nga Komuna Otlak, janë pajisur me certifikatë transportit për nevojat e veta një numër i konsiderueshëm subjektesh.

Nga këto **88 subjekte** nuk janë regjistruar në QKR, nga të cilat; në vitin 2012, nuk janë regjistruar 38 subjekte; në vitin 2014 nuk janë regjistruar 36 mjete dhe në vitin 2015 nuk janë regjistruar 14 subjekte.

Subjektet të cilat nuk janë regjistruar për aktivitetin e tyre në QKR, ushtrojnë aktivitet pa leje dhe janë pajisur me certifikatë transporti nga komuna. Në këtë rast, këto subjekte, nuk kanë paguar taksën e biznesit të vogël për veprimtari transporti, për vitet 2013,2014 dhe 5/mujori i vitit 2015 për vlerën **1,355,000 lekë, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Komunës, në kundërshtim me ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportin Rrugorë” me ndryshime, Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugorë” me ndryshime, neni 30, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 40 dhe ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, pika 5.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Berat (në të cilën përfshihet si njësi administrative ish Komuna Otlak), të ndjekë procedurat e nevojshme për arkëtimin e detyrimeve për taksën e lejes së transportit nga **88 subjekte** të pa regjistruara në QKR.

Brenda muajit Dhjetor 2015

2. Gjetje nga auditimi: Komuna Otlak, ka në administrimin e saj Ujësjetllësin për furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës.

Kryerja e këtij shërbimi, është bërë bazuar në kontratat tip të furnizimit të lidhura me 977 abonentët familjarë.

Aktualisht, janë 418 abonentë familjarë debitorë për mos pagimin e faturave për furnizimin me ujë të pijshëm në shumën **1,308,330 lekë, e cila është shkelje e disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Komunës dhe duhet të paguhet nga abonentët familjarë debitorë. Mos vjela e detyrimeve debitorë, është në kundërshtim me kërkesat e vendimeve të Këshillit të Komunës nr. 3, datë 24.01.2013, nr. 5, datë 10.2.2014, dhe nr. 49, datë 13.2.2015, kontratën tip “Për furnizimin me ujë të pijshëm” dhe nenit 850 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar .

2.1.Rekomandimi: Bashkia Berat (në të cilën përfshihet si njësi administrative ish Komuna Otlak), të marrë masat e nevojshme dhe të procedohet sipas kërkesave ligjore për vjeljen e detyrimeve debitorë për arkëtimin e shumës 1,308,330 lekë nga 418 abonentë debitorë.

Brenda muajit Dhjetor 2015

3.Gjetjet nga auditimi: Operatori “P.....” shpk, ka përfituar për punime të pa kryera në objektin “Rikonstruksioni i banesave të komunitetit Rom, ndërhyrje në infrastrukturë dhe K.U.Z në fshatin Moravë” në shumën **682,775 lekë pa tvsh me dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit, në kundërshtim me kontratën nr. s'ka prot., datë 27.11.2014.

3.1.Rekomandimi: Të kërkohet arkëtimi i dëmit për **682,775 lekë** nga përfituesit operatori “P.....” shpk.

Menjëherë

4.Gjetjet nga auditimi: Operatori “B.....” shpk, ka përfituar për punime të pa kryera në objektin “Rikonstruksioni i banesave të komunitetit Rom, ndërhyrje në infrastrukturë dhe K.U.Z në fshatin Moravë, faza II” në shumën **501,382 lekë pa tvsh me dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit, në kundërshtim me kontratën nr. s'ka prot., datë 03.12.2014.

4.1.Rekomandimi: Të kërkohet arkëtimi i dëmit për **501,382 lekë** nga përfituesit operatori “B.....” shpk.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2014, nuk është llogaritur dhe mbajtur tatimi në burim në masën 10% të pagës për 22 punonjës të sektorit të shërbimeve në shumën **224,968 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e pika 2, neni 9, të ligjit 8438, datë 28.12.1998 “Tatimi mbi të ardhurat” me ndryshime .

5.1.Rekomandimi: Bashkia Berat (në të cilën përfshihet si njësi administrative ish Komuna Otlak), të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit nga 22 punonjës të sektorit të shërbimeve sipas listës emërore.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: U konstatua se në dy raste në vitin 2013, janë paguar shtesë page për pozicionin e punës **më tepër për 89,266 lekë** se sa miratimi me Vendim të Këshillit të Komunës dhe në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore” me ndryshimet .

6.1.Rekomandimi: Bashkia Berat (në të cilën përfshihet si njësi administrative ish Komuna Otlak), të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit nga përfituesit e shtesës së pagës për pozicion:

- **Vlera 44,690 lekë** në ngarkim të z. V.A- ish p/zyrës së financës;

- **Vlera 44,576 lekë** në ngarkim të zj. L.K –p/zyrës së financës.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Kryetarit Bashkisë Berat, (në të cilën përfshihet si njësi administrative ish Komuna Otlak), mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij, si dhe të kontratës individuale të punës, i kemi rekomanduar të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe

performancën e punonjësve të ish Komunës Otlak bazuar në gjetjet e trajtuara në Raportin e Auditimit dhe të japë masën disiplinore: **“Vërejtje”** deri në **“Largim nga puna”** për:

1-Zj. L.K, Përgjegjëse e Zyrës së Financës.

-Nuk janë llogaritur e mbajtur tatim në burim për 22 punonjës, në kundërshtim me kërkesat e pikës 2, neni 9, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 Tatim mbi të ardhurat, i ndryshuar.

-Përsa janë dhënë ndihma ekonomike në kundërshtim me kërkesat e kap. I, neni 3, kap. III, neni 7, kap. IV, neni 10 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

-Janë paguar shpenzime për udhëtime e dieta, pa dokumenta të rregullta financiarë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 29, pika 2, VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, kap. I dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pikat 35/a dhe 35/b dhe ngarkon

-Për mangësi në mbajtjen e kontabilitetit dhe pasqyrta financiare, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar neni 7, 8, 14.

2- Z. P.Gj, Përgjegjës i Zyrës së tatim Taksave.

-Nuk janë zbatuar procedurat ligjore në vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë” me ndryshime.

-Janë pajisur me certifikatë transporti, subjekte private në 55 raste në kundërshtim me ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportin Rrugorë” me ndryshime, Udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugorë” me ndryshime, neni 30 dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 40.

3- Zj. A.Gj, me detyrë specialiste për ndjekjen e arkëtimit nga tarifa e ujit të pijshëm.

-Nuk janë ndjekur detyrimet debitorë në kundërshtim me vendimet e Këshillit të Komunës nr 3, datë 24.01.2013, nr 5, datë 10.2.2014, dhe nr 49, datë 13.2.2015, kontratën tip “Për furnizimin me ujë të pijshëm” dhe nenit 850 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

4- Z. E.D, me detyrë Inspektor i IMKT-së nga 21.02.2014 e në vazhdim.

-Për mos përmbushje të detyrimeve ligjore dhe mos zbatimin e plotë të kërkesave për 5 raste të evidentuara ndërtime pa leje, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, VKM-së nr.862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV” i ndryshuar dhe Rregullores së brendshme “Për Organizimin e veprimtarisë së punonjësve të Komunës Otlak”.

D.1. MASA ADMINISTRATIVE

1. Nga Bashkia Berat, të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit Kontrollit Mbrojtjes së Territorit, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për ing. N.M,** nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

Dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **1,184,157 lekë pa T.V.SH** si rrjedhojë e situacionimit të volumeve të punimeve të pakryera;

Mangësi në dokumentacion;

Konkretisht:

-Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt: “Rikonstruksioni i banesave të komunitetit Rom, ndërhyrje në infrastrukturë dhe K.U.Z në Moravë, faza II” Otlak me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën **501,382 lekë pa T.V.SH** si dhe mangësi në dokumentacion;

-Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt: “Rikonstruksioni i banesave të komunitetit Rom, ndërhyrje në infrastrukturë dhe K.U.Z në Moravë” Otlak me pasojë dëm ekonomik ndajë

buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **682,775 lekë pa T.V.SH** dhe mangësi në dokumentacion;

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, kontratat për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Komuna Otllak dhe ing. N.M dhe me udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

2. Nga Bashkia Berat, të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit Kontrollit Mbrojtjes së Territorit, **të vendosë masë administrative me gjobë për ing. L.V**, nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

Dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **501,382 lekë pa T.V.SH** si rrjedhojë e situacionimit të volumeve të punimeve të pakryera e konkretisht në objektin “Rikonstruksioni i banesave të komunitetit Rom, ndërhyrje në infrastrukturë dhe K.U.Z në Moravë, faza II” Otllak.

Mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

D.2. MASA ADMINISTRATIVE:

Nga auditimi i ushtruar në Komunën Otllak, u konstatuan mangësi dhe shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, date 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 7, pika 2, 3/a, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që në zbatim të nenit 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, i kemi kërkaur të shqyrtojë dhe të marrë masa disiplinore ndaj anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, konkretisht:

1. **V.P, specialiste e Financës, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.**
2. **B.S, ish punonjëse Komunës, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.**
3. **A.S, ish punonjëse Komunës, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.**
4. **L.K, Përgjegjëse e Zyrës së Financës, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.**
5. **Z.C, specialist i Zyrës së Urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.**
6. **L.M, inspektor i Zyrës së Tatim Taksave, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.**
7. **E.D, specialist Veterinar, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.**
8. **L.S, ish punonjës i Komunës, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.**

-Për shkelje të rregullave të prokurimit publik, në tenderin me objekt: **“Rikonstruksion i banesave të komunitetit Rom, ndërhyrje në infrastrukturë fshati Moravë, Komuna Otllak (Fazë e I)”,** zhvilluar sipas urdhër prokurimit nr. 11, datë 24.9.2014.

-Për shkelje të rregullave të prokurimit publik, në tenderin me objekt: **“Blerje Kamioni i Përdorur”** viti 2014, zhvilluar sipas urdhër prokurimit Nr. 6, datë 22.5.2014.

Nga Bashkia Berat (për llogari të ish komunës Otllak,) ka kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Josif Lile, Përparim Gjuzi, Julian Adili dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT